Paneli këshillëdhënës për të drejtat e njeriut
Building D, UNMIK HQ, Prishtinë/Kosovë | E-mail: hrap-unmik@un.org | Tel: +381 (0)38 504-604, ext. 5182

MENDIM

Data e miratimit: 30 maj 2014

Lënda nr. 319/09

Nevenka RISTIQ

kundër

UNMIK-ut

Paneli Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut, i mbledhur më 30 maj 2014, me pjesëmarrjen e këtyre anëtarëve:

Z. Marek Nowicki, kryesues
Znj. Christine Chinkin
Znj. Françoise Tulkens

Të ndihmuar nga

Z. Andrey Antonov, zyrtar ekzekutiv

Pasi mori parasysh ankesën e lartpërmendur, e parashtruar në pajtim me nenin 1.2 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/12, të datës 23 mars 2006, mbi themelimin e Panelit Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut,

Pas shqyrtimit të vëmendshëm, paraqet gjetjet dhe rekomandimet si në vijim:

I. PROCEDURAT PARA PANELIT

1. Ankesa është paraqitur më 23 mars 2009 dhe është regjistruar më 12 nëntor 2009.

2. Më 9 korrik 2011, Paneli kërkoi informata në lidhje me ankesën nga Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës mbi çështjet e lidhura me Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit (Dhoma e Posaçme). Një përgjigje është pranuar nga Dhoma e Posaçme më 9 gusht 2011.

3. Më 11 gusht 2011, Paneli kërkoi informata shtesë nga Dhoma e Posaçme. Dhoma e Posaçme është përgjigjur më 18 gusht 2011.

4. Më 5 tetor 2011, Paneli kërkoi nga ankuesja të dorëzojë informata shtesë.Përgjigja e ankueses është pranuar më 8 dhjetor 2011.

5. Më 26 shtator 2012, Paneli e shpalli ankesën të pranueshme.

6. Më 16 tetor 2012, Paneli e njoftoi PSSP-në për vendimin mbi pranueshmërinë, lidhur me dhënien e komenteve të UNMIK-ut mbi bazueshmërinë e rastit. Më 14 nëntor 2012, PSSP-ja dha përgjigjen e UNMIK-ut.

7. Më 20 nëntor 2013, Paneli kërkoi informata shtesë nga ankuesja. Po të njëjtën ditë, ankuesja ofroi përgjigjen e vet.

8. Më 3 dhjetor 2013, Paneli mblodhi informata shtesë për rastin nga Dhoma e Posaçme.

9. Më 18 dhjetor 2013, Paneli, në dritë të informatave shtesë të pranuara, kërkoi nga PSSP-ja që të ofrojë komente shtesë mbi bazueshmërinë e rastit. PSSP-ja dha përgjigjen e UNMIK-ut më 16 janar 2014.

10. Më 20 shkurt 2014, Paneli e rinjoftoi PSSP-në për ankesën, lidhur me dhënien e komenteve të UNMIK-ut mbi pranueshmërinë dhe bazueshmërinë e rastit. PSSP-ja dha përgjigjen e UNMIK-ut më 1 prill 2014.

II. FAKTET

11. Ankuesja është ish-banore e Kosovës, e cila tani jeton në Mal të Zi. Ajo deklaron se ishte e punësuar në ndërmarrjen shoqërore "Eximkos", në Prishtinë, prej dhjetorit të vitit 1975 deri më 1999, kur ajo u largua nga Kosova për shkaqe sigurie dhe u bë person i shpërngulur në Mal të Zi. Ajo deklaron më tutje se zyrtarisht e mbajti statusin e të punësuarës në "Eximkos" derisa ajo u "pensionua" në vitin 2000.

12. Ankuesja deklaron se, më 31 maj 2007, ajo ia paraqiti një kërkesë Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit (AKM), duke kërkuar të drejtën e saj për pjesën në të ardhurat e privatizimit të ndërmarrjes "Eximkos". Më 21 tetor 2007, AKM-ja publikoi listën e punëtorëve të kualifikuar për një pjesë të të ardhurave të privatizimit, e cila përfshinte emrin e ankueses.

13. Sipas informatave që Paneli i pranoi nga Dhoma e Posaçme më 3 dhjetor 2013, një grup i punëtorëve të "Eximkos-it" paraqiti një ankesë, më 15 maj 2008, kundër përfshirjes së 35 personave, në mesin e tyre edhe ankueses, në listën e AKM-së të punëtorëve të kualifikuar. Në ankesë thuhet se punësimi i ankueses në "Eximkos" ishte ndërprerë me një vendim të ndërmarrjes nr. 426, i datës 29 nëntor 2000, se emri i saj nuk "figuronte në të ardhurat personale për vitin 1999", dhe se ajo nuk e kishte "librezën e punës". Në ankesë thuhet më tej se menaxhmenti i "Eximkos-it" kishte vendosur t'ua ndërpresë marrëdhënien e punës atyre punëtorëve, sikur ankuesja, të cilët nuk ishin paraqitur në punë brenda një viti, nga 29 gushti i vitit 1999. Në ankesë gjithashtu thuhet se, sipas mendimit të tyre, asnjëri nga punëtorët në fjalë nuk është diskriminuar, "sepse personat e njëjtë me muaj kanë qenë në Prishtinë" derisa ata kishin dëgjuar se ndërmarrja po privatizohej dhe derisa ata "kishin shitur banesat e tyre që u ishin dhënë nga "Eximkos-i".

14. Më 20 nëntor 2007, AKM-ja ia dorëzoi Dhomës së Posaçme përgjigjen e vet ndaj ankesës së lartpërmendur në të cilën kundërshtohej lista e saj e punëtorëve të kualifikuar për një pjesë të të ardhurave të privatizimit. AKM-ja deklaroi se kundërshtimi kundër përfshirjes së ankueses ishte i pabazuar. Sipas AKM-së, ankuesja ofroi një kopje të librezës të saj të punës, "akoma e hapur", e cila tregonte për punësimin e saj në ndërmarrje. Veç kësaj, ankuesja kishte pasur pretendime për rrethanat, përkatësisht

dështimin e saj për t'u paraqitur në punë në ndërmarrje pas vitit 1999, për shkak të situatës së pasigurt, nga e cila mund të supozohej diskriminimi. Në lidhje me këtë AKM-ja rikujtoi arsyetimin e Dhomës së Posaçme në rastet e ndërmarrjes *Termosistem* (SCEL-04-001, vendimi i 9 korrikut të vitit 2004) dhe ndërmarrjes *Progres* (SCEL-05-002, vendimi i 20 janarit të vitit 2006), që tregon se tensionet në vija etnike në Kosovë, duke përfshirë Prishtinën, ishin "të dokumentuara mirë", pra një çështje "përgjithësisht e njohur",e cila nuk kishte nevojë të dëshmohej, dhe se dështimi i autoriteteve për të marrë parasysh gjendjen e grupeve të ndryshme etnike gjatë procesit të privatizimit arrinte në diskriminim indirekt. AKM-ja gjithashtu theksoi se ata punëtorë, të cilët kundërshtojnë përfshirjen e ankueses në listë, nuk kishin provuar se diskriminimi nuk ekzistoi në atë rast specifik.

15. Në dokumentet e pranuara nga Dhoma e Posaçme tregohet se, më 18 qershor 2008, ankuesja paraqiti një parashtresë me shkrim si përgjigje ndaj ankesës, në të cilën kundërshtohej përfshirja e saj në listë (§ 13). Ankuesja argumentonte se pretendimet e bëra kundër saj ishin tendencioze dhe nuk mbështeten në dëshmi. Në veçanti, ajo theksoi se nuk ishte informuar nga menaxhmenti i "Eximkos-it" se punëtorët duhej të paraqiteshin në punë brenda një viti apo se punësimi i saj ishte ndërprerë në nëntor të vitit 2000. Ajo gjithashtu deklaroi se nuk ishte "e vërtetë" se ajo nuk e kishte librezën e punës që dëshmonte për punësimin e saj në "Eximkos". Në fakt, libreza e saj e punës ishte mbajtur në ndërmarrje derisa ajo arriti ta rimarrë atë përmes një shoku shqiptar në vitin 2001. Më pas, libreza i ishte dorëzuar AKM-së "së bashku me të gjitha dokumentet e tjera". Ankuesja gjithashtu deklaroi se ajo kishte pranuar shkurtazi informata rreth ankesës kundër përfshirjes së saj në listë përmes telefonit dhe, derisa priste të pranojë një kopje të saj, ajo i kishte shkruar Dhomës së Posaçme për t'i kërkuar që ankesa të mbështetet me dëshmi, që këtu nuk ishte rasti.

16. Në dosjen e Dhomës së Posaçme gjithashtu shihet se në një datë të paspecifikuar, pas pranimit të një kopje me faks të ankesës kundër saj, ankuesja i paraqiti komente shtesë Dhomës së Posaçme. Ajo deklaroi se po ridorëzonte kopjet e dokumenteve, duke përfshirë librezën e saj të punës, që dëshmonte për punësimin e saj në "Eximkos". Ajo gjithashtu deklaroi se ankesa kundër saj ishte paraqitur duke u bazuar vetëm në "diskriminimin kundër punëtorëve joshqiptarë". Veç kësaj, pasi ajo ishte duke jetuar si person i shpërngulur në Mal të Zi dhe nuk kishte të ardhura në atë kohë, ajo nuk ishte në gjendje të shkojë dhe të marrë pjesë në seancën e shqyrtimit në Kosovë; megjithatë ajo shpresoi se të gjitha dokumentet që ajo i kishte dërguar do të ishin të mjaftueshme të "dëshmojnë se ankuesit ishin gabim". Bashkëngjitur me parashtresën e ankueses për Dhomën e Posaçme është një kopje e vërtetuar e librezës të saj të punës (faqet 1, 2, 3 , 6 dhe 7), ku thuhet se ajo ishte e punësuar në "Eximkos" në Prishtinë prej vitit 1975 dhe nuk tregon për ndonjë datë të ndërprerjes së punësimit (prandaj "akoma është e hapur"). Ajo gjithashtu bashkëngjiti një kopje të kartelës së saj të sigurimit shëndetësor, në të cilën gjithashtu thuhet se ajo ishte e punësuar në "Eximkos" në Prishtinë dhe e tregonte shkurtin e vitit 1999 si datën e fundit të ripërtëritjes.

17. Më 23 tetor 2008, Dhoma e Posaçme mori një vendim mbi çështjen (SCEL-08-002),që e përjashtonte ankuesen nga lista e punëtorëve të kualifikuar. Në vendim thuhej se ai ishte "përfundimtar, juridikisht i detyrueshëm dhe nuk mund të apelohet". Sipas arsyetimit të Dhomës së Posaçme ankuesja

> "nuk paraqiti dëshmi të vërtetuar nga një organ kompetent që do të tregonte se libreza e saj e punës ishte e hapur; por ajo paraqiti vetëm faqen e parë të librezës së punës, e cila nuk dëshmon se ajo ishte e punësuar në NPSH "Eximkos" me seli në Prishtinë. Kjo dëshmi nuk mund ta verifikojë faktin se ajo e kishte statusin e të punësuarës deri

në datën e privatizimit. Gjithashtu, ajo nuk paraqiti ndonjë dëshmi tjetër relevante siç parashihet me ligj, për të verifikuar faktin se ajo ishte e punësuar deri me datën e privatizimit. Poashtu, ajo nuk provoi se ishte e diskriminuar. Prandaj, ajo padrejtësisht ishte vlerësuar si punëtore e kualifikuar në pajtim me nenin 10.4 të Rregullores 20003/13".

18. Në parashtresën e saj për Panelin, ankuesja deklaron se, pasi ajo nuk kishte pranuar "asnjë thirrje për proces gjyqësor, ankesë, njoftim apo të ngjashme" në adresën e saj në Mal të Zi, dhe pasi ajo kishte besim në të drejtën e saj, në dhjetor të vitit 2008 ajo shkoi së bashku me kolegët e saj në "Kasabank", për të marrë pjesën e saj nga të ardhurat, vetëm për të mësuar se ajo nuk e kishte në fakt të drejtën për të marrë para nga privatizimi i ndërmarrjes "Eximkos". Ajo deklaron se vetëm pas kontaktimit nga ana e saj të Dhomës së Posaçme përmes telefonit, ishte informuar për vendimin e marrë më 23 tetor 2008. Me një datë të paspecifikuar në dhjetor të vitit 2008 dhe me kërkesën e saj, asaj i ishte dhënë një kopje e vendimit. Ankuesja deklaron se vendimi bazohej në një vlerësim të gabueshëm të fakteve, meqë ajo i kishte paraqitur Dhomës së Posaçme kopjet e vërtetuara të të dhënave të saj të punësimit që dëshmonin se ajo kishte filluar punën në "Eximkos",në Prishtinë, në vitin 1975, dhe gjithashtu kopjet e dokumenteve të tjera (siç është kartela e saj e sigurimit shëndetësor), që dëshmonin se punësimi i saj ishte në vazhdim në vitin 1999. Ajo deklaron më tutje se, ajo u largua nga Kosova dhe puna e saj pas 24 vjetësh kundër dëshirës së saj dhe si rezultat i diskriminimit, e cila është "diçka që nuk ka nevojë të dëshmohet meqë është një fakt i mirënjohur".

III. ANKESA

19. Ankuesja ankohet në përgjithësi rreth paanësisë së procedurave para Dhomës së Posaçme në lidhje me të drejtën e saj për një pjesë nga të ardhurat e privatizimit të "Eximkos-it". Ajo pohon se ajo ishte në listën e pagave të "Eximkos-it" për 24 vjet para se, për shkak të situatës së sigurisë në Kosovë, ajo të largohej dhe të bëhej person i zhdukur në Mal të Zi. Ajo pohon se kishte të drejtë të marrë një pjesë përkatëse nga të ardhurat e privatizimit. Megjithatë, Dhoma e Posaçme padrejtësisht nuk mori parasysh dëshminë dhe parashtresat e paraqitura nga ajo në lidhje me këtë. Ajo gjithashtu pohon se Dhoma e Posaçme nuk e informoi atë rreth ankesës së paraqitur kundër përfshirjes së saj në listë dhe nuk ia dha asaj me kohë njoftimin për vendimin e saj për ta larguar atë nga lista. Ajo pohon se, për këto arsye, e drejta e saj për gjykim të drejtë, e garantuar me nenin 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ) ishte shkelur.

20. Veç kësaj, ankuesja ankohet se Dhoma e Posaçme nuk e mori parasysh diskriminimin indirekt kundër personave nga komuniteti serb. Ajo deklaron se nuk ishte në gjendje të vazhdojë punën në ndërmarrje për shkak se, si një e punësuar serbe, ajo ishte e detyruar të largohet nga Kosova për shkaqe sigurie. Si pasojë, ajo *de facto* ishte eliminuar nga procesi i privatizimit. Në lidhje me këtë, ajo pohon për shkelje të nenit 14 të KEDNJ-së, në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së.

IV. LIGJI

A. Parashtresat e palëve

Parashtresat e ankueses

21. Ankuesja pretendon se ajo ishte përjashtuar padrejtësisht nga Dhoma e Posaçme nga lista e punëtorëve të kualifikuar që të marrin një pjesë nga të ardhurat e privatizimit të ndërmarrjes "Eximkos". Ajo pohon se ishte e punësuar në këtë ndërmarrje që nga viti 1975 dhe se në vitin 1999 ajo ishte e detyruar të largohet nga Kosova për shkak të diskriminimit dhe kërcënimeve për sigurinë e saj, Prandaj, ajo i plotësoi kriteret e përcaktuara me ligj për t'u përfshirë në listën e punëtorëve të kualifikuar.

22. Ankuesja argumenton se procedurat para Dhomës së Posaçme nuk ishin të drejta dhe kështu shkelnin nenin 6 të KEDNJ-së për numrin e pikave. Ajo ankohet se Gjykata nuk e njoftoi atë si duhet për procedurat, në të cilat e drejta e saj për një pjesë nga të ardhurat ishte kundërshtuar dhe ia dorëzoi asaj një kopje të vendimit të saj përfundimtar vetëm në dhjetor të vitit 2008, kur ajo e kërkoi atë. Ajo gjithashtu deklaron se të gjeturat e Dhomës së Posaçme bazoheshin ekskluzivisht në deklaratat e pavërteta të punëtorëve të tjerë dhe nuk mori parasysh parashtresat dhe dëshminë të paraqitura nga ajo. Në veçanti, ankuesja deklaron se Dhoma e Posaçme nuk e mori parasysh dëshminë e dokumentuar, do të thotë një kopje të vërtetuar të librezës të saj të punës, që dëshmonte për punësimin e saj në "Eximkos" që nga viti 1975, dhe gjithashtu parashtresën e saj se ajo ishte diskriminuar për shkak të etnisë së saj serbe. Në të vërtetë, sipas ankueses, "ekzistenca e qartë e diskriminimit indirekt kundër personave të nacionalitetit serb dhe nacionaliteteve të tjera minoritare", është një "fakt i mirënjohur" i cili "nuk ka nevojë të dëshmohet në bazë të veçantë".

23. Ankuesja ankohet më tutje se Dhoma e Posaçme nuk mori parasysh diskriminimin indirekt të personave me etni serbe dhe minoriteteve të tjera, etnike duke shkelur nenin 14 të KEDNJ-së. Për shkak të situatës së sigurisë në Kosovë, si një e punësuar serbe ajo nuk ishte "në gjendje të hyjë në ndërmarrje" dhe t'i kryejë aktivitetet e saj të punës.Ajo deklaron se "nëse rrethanat do të lejonin vazhdimin e jetës dhe punës për personat serbë dhe nacionalitetet e tjera minoritare në territorin e Kosovës", ajo "do të vazhdonte të jetë në listën e punëtorëve të kualifikuar", sipas kritereve të vendosura në nenin 10.4 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2003/13. Në dritë të këtyre rrethanave, një interpretim i ngushtë i dispozitës së lartpërmendur "i sjell në një situatë të pafavorshme në mënyrë të pajustifikueshme një numër personash që u takojnë nacionaliteteve të rrezikuara minoritare, të cilëve kështu objektivisht u mohohet pjesa e tyre nga të ardhurat e privatizimit, në kundërshtim me nenin 14".

Parashtresat e PSSP-së

24. Duke hedhur poshtë mundësinë që ankuesja të mund të mbështetet në shkeljen e nenit 6 § 1 të KEDNJ-së, PSSP-ja ofron argumentet në vijim. E para, PSSP-ja deklaron se ankuesja " kishte, gjithë kohën, qasje në mjetet juridike" dhe se po t'i kishte shfrytëzuar ankuesja këto mjete juridike, "Dhoma e Posaçme do të ishte në pozitë të shqyrtojë ligjshmërinë e vendimit të vet, për të siguruar aplikim të drejtë ligjit dhe mbikëqyrje të procedurave të drejta". PSSP-ja rikujton praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut se "për të gjykuar nëse është vepruar në pajtim me nenin 6 të KEDNJ-së në çdo fazë të veçantë, vlerësimi duhet bërë për tërësinë e procedurave në rendin ligjor vendor dhe se mangësitë e një faze mund të kompensohen në një fazë tjetër".

25. Për sa i përket mjeteve juridike në dispozicion të ankueses në rastin aktual, PSSP-ja thekson se neni 7 i Rregullores së UNMIK-ut nr. 2008/4, *për ndryshimin e Rregullores së UNMIK-ut nr. 2002/13 mbi themelimin e Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës mbi çështjet e lidhura me Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit* e që ka të bëjë me normat procedurale para Dhomës së Posaçme "nënkupton mundësinë për shqyrtim gjyqësor". Kjo dispozitë i bën të mundur PSSP-së të nxjerrë norma procedurale për

procedurat para Dhomës së Posaçme të cilat "i ofrojnë palës një mundësi kuptimplotë që të ketë vendim për pretendimin e tij, duke përfshirë një shqyrtim gjyqësor të vendimit të tillë … në pajtim me normat e përcaktuara sipas Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe duke marrë parasysh standardet ndërkombëtare përgjithësisht të pranuara. Në rastet që nuk janë mbuluar qartë dhe shprehimisht me norma të tilla procedurale, Dhoma e Posaçme e ka autoritetin që të nxjerrë norma tjera procedurale në përputhje me këto parime."

26. Për më tepër,PSSP-ja argumenton se, "kur ankuesja u vu në dijeni për vendimin e Dhomës së Posaçme në dhjetor të vitit 2008, ajo e kishte çdo të drejtë të paraqesë ankesë ndaj vendimit të Panelit Gjyqësor në pajtim me nenin 67.12 të *Udhëzimit Administrativ të UNMIK-ut nr. 6 të vitit 2008 mbi themelimin e Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme për çështjet e lidhura me Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit*, i cili u bë ligj i aplikueshëm më 31 dhjetor 2008."

27. Si përgjigje ndaj argumentit të ankueses se Dhoma e Posaçme nuk e mori parasysh dëshminë që i ishte paraqitur asaj, PSSP-ja, në komentet e tij fillestare mbi bazueshmërinë, të datës 28 mars 2012, theksoi se nuk kishte dëshmi se Dhoma e Posaçme e kishte vlerësuar dëshminë e ofruar nga ankuesja në një mënyrë të pasaktë. Në veçanti, PSSP-ja theksoi se, sipas Dhomës së Posaçme, ankuesja nuk e kishte dorëzuar dokumentacionin e kërkuar për të dëshmuar se ajo ishte e punësuar në ndërmarrjen "Eximkos" dhe as që kishte provuar se ajo kishte qenë e diskriminuar. Megjithatë, në komentet e tij të datës 16 janar 2014, pas pranimit nga Paneli të dokumenteve shtesë nga dosja e Dhomës së Posaçme, një kopje e veçantë e librezës të vërtetuar të punës të ankueses dhe kartela e sigurimit shëndetësor si pjesë e dosjes së Dhomës së Posaçme (shih § 16 më lart), PSSP-ja deklaroi se "UNMIK-u nuk e konteston se dokumentet mund t'i jenë paraqitur Dhomës së Posaçme nga ankuesja". Megjithatë, sipas PSSP-së "nuk ka dëshmi se Dhoma e Posaçme e kishte vlerësuar dëshminë e ofruar nga ankuesja në një mënyrë të pasaktë gjatë marrjes së vendimit të saj të arsyetuar më 23 tetor 2008". Në këtë kuptim, PSSP-ja argumenton se Paneli "nuk mundet t'ia zë vendin një Paneli ankesash për sa i përket kryerjes së shqyrtimeve dhe/apo nxjerrjes së konkluzioneve për përmbajtjen e një vendimi të gjykuar dhe marrë nga një gjykatë e themeluar në mënyrë të ligjshme që ka juridiksion të duhur për mbikëqyrjen e çështjeve procedurale, vlerësimin e provave apo vërtetimin e dëshmisë". Për këto arsye, PSSP-ja arriti në përfundim se nuk kishte shkelje të nenit 6 që mund të pretendohet nga ankuesja.

28. Për sa i përket pretendimeve të ankueses sipas nenit 14 të KEDNJ-së (ndalimi i diskriminimit), në komentet e tij mbi pranueshmërinë dhe bazueshmërinë e ankesës, PSSP-ja deklaron në fillim se kjo dispozitë e Konventës nuk vlen në këtë rast. Sipas PSSP-së, "vetëm ato çështje të barazisë që janë të lidhura me një dispozitë esenciale në Konventë apo një nga protokollet e saj mund të adresohen në kontekst të nenit 14. Për shkak të natyrës së vet dytësore, në nenin 14 në mënyrë specifike nuk mund të thirremi në çështjet e lidhura me punësim. Për sa i përket aplikimit të tij në lidhje me nenin 6 në një çështje të momentit, neni 14 nuk është i aplikueshëm, prandaj ankuesja nuk mund të thirret në të".

29. PSSP-ja argumenton më tutje se Dhoma e Posaçme në vendimin e vet ka arritur në përfundim se nuk ka pasur diskriminim kundër ankueses. Sipas PSSP-së "si pasojë, dhe veç nëse vlerësimi i dëshmisë nga Dhoma e Posaçme është qartas i pasaktë, procesin gjyqësor duhet konsideruar si të drejtë dhe të saktë dhe vendimin e Dhomës së Posaçme të mos jetë dhënë në bazë të diskriminimit". PSSP-ja gjithashtu deklaron se "nuk është kompetencë e PKDNJ-së të vlerësojë ligjshmërinë dhe saktësinë e vendimeve të marra nga institucionet kompetente gjyqësore, veç nëse ka dëshmi se vendimet e tilla janë marrë

në një mënyrë padyshim jo të drejtë dhe të pasaktë". Veç kësaj, PSSP-ja argumenton se në arsyetimin ligjor të vendimit të vet Dhoma e Posaçme iu ka referuar ligjit të aplikueshëm, më konkretisht nenit 8.1 të Ligjit kundër Diskriminimit të nxjerrë me Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2004/32, duke gjykuar se ankuesja nuk i ka provuar pretendimet e saj se ajo ka qenë e diskriminuar, siç kërkohet me ligjin e lartpërmendur. Përveç kësaj, PSSP-ja rithekson argumentin e tij se ankuesja ka mundur të ankohet për vendimin e Dhomës së Posaçme në pajtim me nenin 4.4 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2008/4, për ndryshimin e Rregullores së UNMIK-ut nr. 2003/13 mbi *themelimin e një Dhome të Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet e lidhura me Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit*, që hyri në fuqi në dhjetor të vitit 2008, me sa duket rreth kohës së njëjtë kur ankuesja u vu në dijeni për vendimin e Dhomës së Posaçme SCEL-08-002.

30. Prandaj, sipas PSSP-së, ankuesja nuk mund të thirret në shkelje të nenit 14 të KEDNJ-së, në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së.

B. Vlerësimi i Panelit

1. Ligji i aplikueshëm vendor

31. Paneli thekson se ankesa e ankueses për t'u përfshirë në listën e punëtorëve të kualifikuar që të marrin një pjesë nga të ardhurat nga privatizimi i"Eximkos-it", ishte shqyrtuar nga Dhoma e Posaçme në dritë të nenit 10 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2003/13, e ndryshuar me Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2004/45 të 19 nëntorit të vitit 2004, që përcakton procedurat ligjore për t'i kundërshtuar listat e punëtorëve të publikuara nga AKM-ja.

32. Neni 10.1 i Rregullores njeh "statusin e veçantë" të punëtorëve të ndërmarrjeve shoqërore dhe ndikimin që privatizimi ka në statusin e tyre. Sipas kësaj dispozite, 20% e të ardhurave nga shitja e aksioneve të një ndërmarrje shoqërore rezervohen për punëtorët e ndërmarrjes, të cilët i plotësojnë kushtet e caktuara. Një punëtor konsiderohet i kualifikuar për një pjesë të të ardhurave, nëse ai/ajo është i regjistruar si punëtor i ndërmarrjes shoqërore në kohën e privatizimit dhe nëse vërtetohet se ka qenë në listën e pagave të ndërmarrjes për jo më pak se tri vjet (neni 10.4).

33. Neni 10.2 dhe 10.3 i Rregullores nr. 2003/13 përcakton procedurën që duhet ndjekur AKM-ja kur krijon një listë të punëtorëve të kualifikuar. Duke marrë parasysh kontekstin e veçantë në të cilin është duke ndodhur privatizimi në Kosovë, neni 10.2 i Rregullores parasheh që, fillimisht, lista e punëtorëve të formulohet në një bazë jodiskriminuese nga organi përfaqësues i punëtorëve në ndërmarrjen përkatëse, në bashkëpunim me Bashkimin e Sindikatave të Pavarura të Kosovës dhe pastaj ajo t'i përcillet AKM-së. Bordi i AKM-së rishikon listën dhe bën rregullimet sipas nevojës për të siguruar qasje të barabartë të punëtorëve në fondet që do të shpërndahen. Lista zyrtare bëhet publike nga AKM-ja, së bashku me një njoftim me të cilin informohen palët e dëmtuara për të drejtën e tyre që të paraqesin ankesë kundër listës (neni 10.3).

34. Ndërsa përcakton kriteret të cilat një punëtor duhet t'i plotësojë me qëllim që të jetë i kualifikuar për t'u përfshirë në listë, në nenin 10.4 të Rregullores thuhet se dështimi për të plotësuar kriteret e tilla nuk është pengesë për përfshirje në listë sapo të dëshmohet se punëtori do të kishte qenë i kualifikuar për përfshirje nëse ajo/ai nuk do të kishte qenë subjekt i diskriminimit. Një person i tillë i dëmtuar mund të paraqesë ankesë në Dhomën e Posaçme në pajtim me nenin 10.6.

35. Neni 10.6 (b) i Rregullores ka të bëjë me dëshminë që i paraqitet Dhomës së Posaçme nga ish-punëtorët që kërkojnë të përfshihen në listë: "Çdo ankesë që i paraqitet Dhomës së Posaçme me bazë diskriminimin si arsye për t'u përjashtuar nga lista e punëtorëve të kualifikuar, duhet shoqëruar me dëshmi dokumentuese për diskriminimin e pretenduar."

36. Në vendimin e vet të 15 qershorit të vitit 2006 Dhoma e Posaçme konsideron se neni 10.6 (b) i Rregullores 2003/13 ishte zëvendësuar me nenin 8.1 të Ligjit Kundër Diskriminimit (Ligji nr. 2004/3), i miratuar nga Kuvendi i Kosovës më 19 shkurt 2004 dhe i shpallur nga PSSP-ja më 20 gusht 2004 (Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2004/32 mbi nxjerrjen e Ligjit Kundër Diskriminimit i miratuar nga Kuvendi i Kosovës).

37. Ligji Kundër Diskriminimit ishte miratuar me qëllim të parandalimit të diskriminimit dhe për të promovuar dhe vënë në zbatim parimin e trajtimit të barabartë të qytetarëve të Kosovës. Dispozitat e tij relevante paraqiten si në vijim:

> Neni 8
>
> Pesha e dëshmisë
>
> 8.1. Kur personat konsiderojnë se atyre u është shkaktuar padrejtësi për shkak se për ata nuk është zbatuar parimi i trajtimit të barabartë para një gjykate apo autoriteti tjetër kompetent, fakte prej të cilave mund të supozohet se ka pasur diskriminim direkt apo indirekt, i takon palës që është paditur të dëshmojë se nuk ka pasur shkelje të parimit të trajtimit të barabartë.
>
> 8.2. Paragrafi 8.1 nuk parandalon zbatimin e rregullave të provave, të cilat janë më të favorshme për paditësit. Veç kësaj, ankuesi mund të ngritë apo mbrojë rastin e tij të diskriminimit me çdo mjet, duke përfshirë të bazuarit në provat statistikore."
>
> Neni 11
>
> 11.1. Kur ky ligj hyn në fuqi, shfuqizon të gjitha ligjet e mëparshme të aplikueshme të kësaj fushe.
>
> 11.2. Dispozitat e paraqitura të legjislacionit apo ato në fuqi për mbrojtjen e parimit për trajtim të barabartë janë akoma valide dhe duhet zbatuar nëse ato janë më të favorshme se dispozitat e këtij Ligji.

2. Pranueshmëria

a) Për sa i përket datës së paraqitjes së ankesës

38. Në fillim, Paneli thekson se, në vendimin e vet mbi pranueshmërinë të 26 shtatorit të vitit 2012, ai konsideroi se ankesa ishte paraqitur më 22 nëntor 2009. Paneli, megjithatë, thekson se ankuesja së pari ia dorëzoi ankesën e vet Panelit përmes Zyrës së UNMIK-ut në Beograd, më 23 mars 2009, siç dëshmohet nga fletëdorëzimi që mban këtë datë, që gjithashtu iu paraqit Panelit.

39. Prandaj, në pajtim me praktikën e vet të qëndrueshme dhe praktikën e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, të merret parasysh si datë vendimtare në të cilën ankesa i është dërguar me postë Panelit dhe jo data në të cilën është pranuar apo regjistruar ankesa (shih, *mutatismutandis*, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ), *Kipritci kundër*

Turqisë, nr. 14294/04, vendimi i 3 qershorit të vitit 2008, § 18; shih gjithashtu Paneli Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut (PKDNJ, B.K., nr. 85/10, vendimi i 22 gushtit të vitit 2012, § 15), Paneli konsideron se ankesa ishte paraqitur më 23 mars 2009.

b) Shkelja e pretenduar e nenit 6 të KEDNJ-së

40. Paneli rikujton se me vendimin e vet mbi pranueshmërinë, i datës 26 shtator 2012, ai e shpalli të pranueshme ankesën sipas nenit 6 të KEDNJ-së (e drejta për gjykim të drejtë) ankesën sipas së cilës Dhoma e Posaçme mesa duket dështoi ta njoftojë ankuesen për procedurat gjyqësore të paraqitura kundër saj në Dhomën e Posaçme. Megjithatë, me shqyrtimin e dokumenteve tjera të pranuara më pas nga Dhoma e Posaçme (shih §§ 8, 15-16 më lart), Paneli duhet të rivlerësojë pranueshmërinë e kësaj pjese të ankesës sipas nenit 6.

41. Siç është theksuar më lart (§ 15-16), dokumentet e pranuara nga Dhoma e Posaçme përfshijnë dy parashtresa me shkrim nga ankuesja për Dhomën e Posaçme, të cilat pa mëdyshje tregojnë, në kundërshtim me deklaratat e saj, se ankuesja ishte informuar për procedurat kundër saj dhe në të vërtetë kishte marrë pjesë në to. Për këtë arsye, Paneli konsideron se kjo pjesë e ankesës është e papranueshme si qartas e pabazë në pajtim me nenin 3.3 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/12 *mbi themelimin e Panelit Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut*.

42. Për sa i përket ankesës së ankueses rreth paanësisë së procedurave para Dhomës së Posaçme, Paneli thekson argumentet e PSSP-së se kërkesa për paanësi mbulon procedurën në tërësi dhe jo vetëm një aspekt apo instancë të tyre dhe mangësitë në një fazë mund të kompensohen në një tjetër. Ankuesja i kishte në dispozicion mjetet juridike kundër ligjshmërisë së vendimit të Dhomës së Posaçme – një shqyrtim gjyqësor në pajtim me nenin 7 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2008/4 dhe një ankesë në pajtim me nenin 67.12 të Udhëzimit Administrativ të UNMIK-ut nr. 2008/06 *që ndryshon dhe zëvendëson* Udhëzimin Administrativ të UNMIK-ut nr. 2006/17, *dhe implementimin e Rregullores së UNMIK-ut nr. 2002/13 mbi themelimin e Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme për çështjet e lidhura me Agjencinë Kosovare të Privatizimit*. Në lidhje me këtë, Paneli konsideron se ky argument është i lidhur pikërisht me çështjen nëse ankuesja i kishte shfrytëzuar të gjitha mjetet juridike në dispozicion, të cilat tanimë i kishte adresuar në vendimin e vet mbi pranueshmërinë (PKDNJ, *Ristiq*, nr. 319/09, vendimi i 26 shtatorit të vitit 2012, §§ 9-13).

43. Në vendimin e vet Paneli konsideroi se nuk kishte mjete efektive juridike në dispozicion të ankueses kundër vendimit të Dhomës së Posaçme. Për sa i përket argumentit të PSSP-së, se ankuesja ka mundur të ankohet për vendimin te një organ apelimi në pajtim me nenin 67.12 të Udhëzimit Administrativ të UNMIK-ut nr. 6/2008 *mbi* themelimin e *Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme për çështjet e lidhura me Agjencinë Kosovare të Privatizimit*, Paneli ka theksuar se Udhëzimi Administrativ i UNMIK-ut i përmendur më lart hyri në fuqi vetëm më 31 dhjetor 2008. Prandaj, në kohën e marrjes së vendimit të Dhomës së Posaçme më 25 tetor 2008, dhe gjithashtu në kohën kur ankuesja u vu në dijeni për vendimin diku në dhjetor të vitit 2008, nuk ishte e mundur asnjë ankesë ndaj një vendimi të Dhomës së Posaçme (shih PKDNJ, *Ristiq*, i përmendur më lart, §§ 12-13; shih gjithashtu PKDNJ, *Todoroviq*, nr. 33/08, vendimi i 17 prillit të vitit 2009, § 35).

44. Për sa i përket argumentit të PSSP-së se një mjet shtesë ishte në dispozicion të ankueses në pajtim me nenin 7 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2008/4, Paneli thekson se kjo dispozitë parasheh autoritetin e PSSP-së për të nxjerrë përmes Udhëzimit Administrativ normat procedurale për procedurat para Dhomës së Posaçme për t'i "ofruar palës një

mundësi kuptimplotë që të ketë vendim për pretendimin e tij, duke përfshirë një shqyrtim gjyqësor" në pajtim me parimet e vendosura me KEDNJ-në dhe i ofron Dhomës së Posaçme, në rast të zbrazëtive, autoritetin që të nxjerrë norma tjera procedurale në përputhje me këto parime. Paneli thekson se në gjykimin e Dhomës së Posaçme thuhet se vendimi i saj është "final, juridikisht i detyrueshëm dhe nuk mund të apelohet." Në dritë të një deklarate të tillë të qartë, nuk është e arsyeshme të pritet nga ankuesja të kërkojë mjete juridike të cilat, sipas pranimit të PSSP-së, janë në dispozicion vetëm "duke u nënkuptuar." Paneli konsideron më tutje se, duke pasur parasysh se PSSP-ja sugjeron që ankuesja është dashur t'i drejtohet Dhomës së Posaçme për të kërkuar nxjerrjen e normave tjera procedurale që i ofrojnë asaj të drejtën për shqyrtim gjyqësor, kjo në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohet një mjet efektiv juridik i krijuar me ligj, siç kërkohet nga KEDNJ-ja, neni 6 § 1 (krahasoje, p.sh., GJEDNJ, *Horvat kundër Kroacisë*, nr. 51585/99, vendimi i 26 korrikut të vitit 2001, KEDNJ, 2001-VIII, § 47; GJEDNJ Dhoma e Lartë [DHL], *Sürmeli kundër Gjermanisë*, nr. 75529/01, vendimi i 8 qershorit të vitit 2006, KEDNJ, 2006-VII, § 109; GJEDNJ, *Belevitskiy kundër Rusisë*, nr. 72967/01, vendimi i 1 marsit të vitit 2007, § 60).

45. Prandaj, Paneli e hedh poshtë vërejtjen e PSSP-së dhe e shpall ankesën të pranueshme sipas nenit 6 të KEDNJ-së, se procedurat ishin të padrejta.

c) Shkelja e pretenduar e nenit 14 të KEDNJ-së, shpallur në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së

46. Në komentet e tij në lidhje me pranueshmërinë dhe bazueshmërinë e ankesës sipas nenit 14 të KEDNJ-së, shpallur në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, PSSP-ja së pari deklaron se neni 14 nuk vlen *ratione materiae* në rastin aktual bazuar në argumentet se neni 14, sipas mendimit të tij, vlen vetëm në rastin që është gjetur një shkelje e një dispozite esenciale të Konventës (në këtë rast neni 6) dhe se neni 14 nuk vlen në rastet e lidhura me punësim.

47. E para, Paneli rikujton se që nga fillimi i vitit 1968, në *Rastin e Linguistikës Belge*, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut vazhdimisht deklaroi se ndërsa është e vërtetë se garancia për mosdiskriminim sipas nenit 14 nuk ka ekzistencë të pavarur pasi ajo ka të bëjë vetëm me të drejtat dhe liritë e përcaktuara në Konventë, akoma mund të ketë shkelje të nenit 14 madje edhe kur e drejta esenciale që i referohemi nuk është shkelur, me kusht që faktet në fjalë të bien në kuadër të kufijve të një apo më shumë dispozitave të Konventës (shih GJEDNJ, *Rasti "Në Lidhje me aspekte të caktuara të ligjeve mbi përdorimin e gjuhëve në Belgjikë", kundër Belgjikës*, nr. 1474/62 dhe të tjerët, vendimi i 23 korrikut të vitit 1968, § 9; shih gjithashtu GJEDNJ, *Van Raalte kundër Holandës*, nr. 20060/92, vendimi i 21 shkurtit të vitit 1997, § 33; GJEDNJ, *Petroviq kundër Austrisë*, nr. 156/1996/775/976, vendimi i marsit të vitit 1998, § 22; GJEDNJ, Dhoma e Lartë [DHL], *Stec dhe të tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar*, nr. 65731/01 dhe 65900/01, vendimi i 12 prillit të vitit 2006, § 51; GJEDNJ, *Zarb Adami kundër Maltës*, nr. 17209/02, vendimi i 20 qershorit të vitit 2006, § 42; GJEDNJ [DHL], *Konstantin Markin kundër Rusisë*, nr. 30078/06, vendimi i 22 marsit të vitit 2012, § 124; GJEDNJ [DHL], *Fabris kundër Francës*, nr. 16574/08, vendimi i 7 shkurtit të vitit 2013, § 47).

48. Përveç kësaj, Gjykata Evropiane e ka konfirmuar aplikueshmërinë e nenit 14 në rastet e punësimit (shih, për shembull, GJEDNJ, *Sidabras dhe Džiautas kundër Lituanisë*, nr. 55480/00 dhe 59330/00, vendimi i 27 korrikut të vitit 2004). Në rastet e diskriminimit indirekt, nuk ka kërkesë për të provuar qëllimin diskriminues (shih GJEDNJ [DHL], *D.H. dhe të tjerët kundër Republikës Çeke*, nr. 57325/00, vendimi i 13 nëntorit të vitit 2007, § 194; dhe GJEDNJ, *Horváth dhe Kiss kundër Hungarisë*, nr. 11146/11, vendimi i 29 janarit të vitit 2013 § 106).

49. Paneli thekson se në rastin aktual ankuesja pohon se ajo ishte diskriminuar për sa u përket procedurave para Dhomës së Posaçme. Procedurat e tilla nënkuptojnë një vendim për të drejtat civile të ankueses dhe obligimet dhe kështu e sjellin lëndën e ankesës në kuadër të nenit 6 të KEDNJ-së. Sipas mendimit të Panelit, kjo është e mjaftueshme për ta bërë të aplikueshëm nenin 14 (shih gjithashtu PKDNJ, *Guga*, nr. 47/08, mendimi i 24 janarit të vitit 2014, §§ 58-60). Prandaj, Paneli e hedh poshtë vërejtjen e PSSP-së në lidhje me këtë.

50. E dyta, Paneli thekson se PSSP-ja, gjithashtu për sa i përket pranueshmërisë së ankesës sipas nenit14 të KEDNJ-së, në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, përsërit argumentin e tij se ankuesja ka mundur të apelojë vendimin e Dhomës së Posaçme. Pasi Paneli konsideron se, me këtë argument, PSSP-ja sugjeron se nuk janë shterur të gjitha mjetet juridike në dispozicion nga ankuesja, Paneli i referohet arsyetimit të vet mbi pranueshmërinë e ankesës sipas nenit 6 (shih §§42-45 më lart) që, në fakt, nuk ka pasur asnjë mjet juridik efektiv në dispozicion të ankueses kundër vendimit të Dhomës së Posaçme. Prandaj Paneli e hedh poshtë vërejtjen e PSSP-së në lidhje me këtë dhe e shpall këtë pjesë të ankesës të pranueshme.

2. Bazueshmëria

a) Shkelja e pretenduar e nenit 6 të KEDNJ-së

51. Duke pasur parasysh se ankesa sipas nenit 6 të KEDNJ-së është shpallur e pranueshme, ankuesja ankohet rreth dy aspekteve të procedurave para Dhomës së Posaçme: dështimin e Dhomës së Posaçme që t'i marrë parasysh dëshminë dhe parashtresat e paraqitura në përkrahje të përfshirjes së saj në listën e punëtorëve të kualifikuar dhe vonesën për ta njoftuar atë për vendimin e Dhomës së Posaçme.

Shqyrtimi i dëshmisë dhe parashtresave nga Dhoma e Posaçme

52. Ankuesja në esencë ankohet se të gjeturat e Dhomës së Posaçme në rastin e saj ishin arbitrare, në shkelje të nenit 6 të KEDNJ-së. Ajo deklaron se ia ofroi Dhomës së Posaçme një kopje të vërtetuar të librezës së saj të punës dhe gjithashtu një kopje të kartelës së saj të sigurimit shëndetësor, që dëshmonin për punësimin e saj në "Eximkos" prej vitit 1975 deri më 1999. Ajo gjithashtu ia paraqiti një parashtresë Dhomës së Posaçme se ajo nuk mundi të vazhdonte punën në ndërmarrje pas qershorit të vitit 1999 për arsye të diskriminimit, për shkak të etnisë së saj serbe, e cila është një rrethanë "e mirënjohur". Prandaj, ajo i plotësoi kriteret e përcaktuara me ligj për të marrë një pjesë të të ardhurave të privatizimit. Megjithatë, në vendimin e saj, Dhoma e Posaçme vendosi ta largojë atë nga lista e punëtorëve të kualifikuar.

53. Paneli pajtohet me PSSP-në se nuk është nën juridiksionin e tij t'ua zë vendin për vlerësimin e fakteve autoriteteve nacionale gjyqësore, në rastin aktual Dhomës së Posaçme. Paneli i referohet jurisprudencës së vet dhe jurisprudencës së Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut se, si rregull e përgjithshme, u takon gjykatave kompetente të vlerësojnë dëshminë para tyre, t'i vërtetojnë faktet dhe t'i interpretojnë ligjet vendore. Paneli, në parim, nuk do të ndërhyjë në vlerësimin e tillë përveç nëse vendimet e marra nga gjyqet kompetente duken arbitrare apo qartë të paarsyeshme (shih GJEDNJ, *I.J.L. dhe të tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar*, nr. 29522/95, 30056/96 dhe 30574/96, vendimi i 19 shtatorit të vitit 2000, § 99, *KEDNJ*, 2000-IX; GJEDNJ, *Khamidov kundër Rusisë*, nr. *72118/01*, vendimi i 15 nëntorit të vitit 2007, § 170; shih gjithashtu PKDNJ, *Parliq*, nr. 01/07, mendimi i 18 qershorit të vitit 2010, § 35). Detyra e Panelit është të konstatojë nëse procedurat në tërësinë e tyre, duke përfshirë mënyrën në të

cilën është vlerësuar dëshmia, ishin të drejta (GJEDNJ, *Ebanks kundër Mbretërisë së Bashkuar*, nr. 36822/06, vendimi i 26 janarit të vitit 2010, § 74; GJEDNJ, *Khamidov kundër Rusisë*, përmendur më lart, § 170; PKDNJ, *Parliq*, përmendur më lart,§ 35).

54. Paneli thekson se ankuesja ishte përfshirë fillimisht nga AKM-ja në listën e punëtorëve të kualifikuar dhe se një ankesë ishte paraqitur kundër saj në Dhomën e Posaçme nga një grup i punëtorëve të "Eximkos-it",që pohonin se ajo nuk "figuronte në të hyrat personale që nga viti 1999" dhe se ajo nuk kishte "librezë të punës".

55. Në dosjen e Dhomës së Posaçme tregohet se, në përkrahje të pohimit të saj për t'u përfshirë në listën e punëtorëve të kualifikuar, ankuesja deklaroi se ajo kishte punuar në ndërmarrje që nga viti 1975, se në mars të vitit 1999 për shkak të situatës së sigurisë në Kosovë ajo u bë person i zhdukur në Mal të Zi; megjithatë, punësimi i saj në ndërmarrje nuk ishte ndërprerë zyrtarisht derisa ajo doli në pension në vitin 2010. Në përkrahje të pohimit të saj, ajo i dorëzoi Dhomës së Posaçme një kopje të vërtetuar të faqeve 1,2,3, 6 dhe 7 të librezës së saj të punës që dëshmonte për punësimin e saj në "Eximkos" në Prishtinë që nga viti 1975 (libreza e punës"e hapur") dhe një kopje të kartelës së saj të sigurimit shëndetësor si punëtore e "Eximkos-it" në Prishtinë, e ripërtërirë për herën e fundit në shkurt të vitit 1999. Në përkrahje të përfshirjes së ankueses në listë, AKM-ja i kishte paraqitur parashtresat e veta në Dhomën e Posaçme, duke konfirmuar se ajo kishte ofruar një kopje të librezës së saj të punës, "akoma e hapur", që tregonte për punësimin në ndërmarrje. AKM-ja gjithashtu kishte deklaruar se ankuesja dhe të punësuarit e tjerë që i takonin minoritetit serb dhe minoriteteve tjera etnike kishin dështuar të paraqiteshin në ndërmarrje pas vitit 1999 për shkak të situatës së pasigurt të sigurisë dhe jo për shkak se "kishin munguar vullnetarisht" në vend të punës. Kështu ajo kishte paraqitur rrethanat që tregojnë diskriminimin.

56. Dhoma e Posaçme vendosi se ankuesja nuk i plotësoi kriteret për të marrë një pjesë nga të ardhurat e privatizimit sipas këtyre bazave: "ajo nuk paraqiti dëshmi të vërtetuar nga organi kompetent për të treguar se libreza e saj e punës ishte e hapur"; "ajo dorëzoi vetëm faqen e parë të librezës së punës, e cila nuk tregon se ajo ishte e punësuar në NPSH me seli në Prishtinë"; ajo nuk paraqiti dëshmi se "ajo kishte statusin e të punësuarit deri me datën e privatizimit"; "ajo nuk dëshmoi se ishte diskriminuar".

57. Paneli është i shqetësuar se Dhoma e Posaçme e injoroi faktin, të konfirmuar nga AKM-ja, se ankuesja e dorëzoi një kopje të librezës së punës, të vërtetuar si duhet dhe "akoma e hapur", dhe gjithashtu një kopje të kartelës së saj të sigurimit shëndetësor, e që të dyja dëshmonin për punësimin e saj në Prishtinë nga viti 1975 deri së paku në shkurt të vitit 1999, pa arsyetuar se pse dokumentet e paraqitura nuk mund të konsideroheshin dëshmi autentike apo të sakta. Për sa i përket elementit të punësimit të ankueses në kohën e privatizimit, Paneli thekson se sipas nenit 10.4 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2003/13 dështimi për të plotësuar kriteret e tilla nuk paraqet pengesë për përfshirje në listë për ata punëtorë të cilët pohojnë se ata akoma do të ishin punëtorë të ndërmarrjes nëse nuk do të kishin qenë subjekt i diskriminimit-e që është pikërisht deklarata e paraqitur nga ankuesja.

58. Në lidhje me këtë, Paneli rikujton se sipas nenit 8 të Ligjit të Kosovës Kundër Diskriminimit, i takon punëtorit, i cili nuk është më duke punuar për ndërmarrjen, t'i vërtetojë faktet nga të cilat mund të supozohet se ka pasur diskriminim direkt apo indirekt, ndërsa i takon palës së kundërt të kundërshtojë supozimin duke dëshmuar se nuk ka pasur diskriminim në rastin specifik. Paneli gjithashtu thekson parashtresën e AKM-së se në rastet e tjera të privatizimit, e njëjta Dhomë e Posaçme kishte gjetur se diskriminimi kundër minoritetit serb dhe minoriteteve tjera etnike pas konfliktit në Kosovë ishte një "çështje përgjithësisht e njohur" e cila nuk kishte nevojë të dëshmohej (shih § 14 më lart;

shih gjithashtu PKDNJ, *Guga*, përmendur në § 49 më lart, në §§ 70-71). Prandaj, Paneli e konsideron befasuese se, pavarësisht nga faktet e paraqitura nga ankuesja – se ajo ishte e detyruar të largohet nga Kosova në mars të vitit 1999 duke pasur frikë për sigurinë e saj- Dhoma e Posaçme ishte e kënaqur me një deklaratë të përgjithshme kundërshtimi të bërë nga ata që kundërshtonin përfshirjen e saj në listë se "nuk ka pasur diskriminim, sepse personat e njëjtë kanë qenë në Prishtinë" derisa ata kishin dëgjuar se ndërmarrja po privatizohej" dhe derisa ata "i kishin shitur banesat e tyre që ua kishte dhënë "Eximkos-i".

59. Prandaj, Paneli konstaton se, duke mos marrë parasysh dëshminë të paraqitur nga ankuesja që dëshmonte për statusin e saj të punësimit në ndërmarrje deri në vitin 1999 dhe duke mos marrë në konsideratë të duhur parashtresën e saj se ajo kishte qenë e diskriminuar, Dhoma e Posaçme nuk i siguroi asaj një gjykim të drejtë. Prandaj, Paneli konsideron se kishte shkelje të nenit 6 të KEDNJ-së në këtë drejtim.

Vonesa në njoftim për vendimin

60. Ankuesja ankohet se ajo nuk ishte njoftuar deri në dhjetor të vitit 2008 për vendimin e Dhomës së Posaçme, që ishte marrë më 23 tetor 2008. Në vendimin e vet mbi pranueshmërinë, Paneli vendosi se kjo pjesë e ankesës duhet shqyrtuar në dritë të së drejtës për një vendim gjyqësor brenda një kohe të arsyeshme, e garantuar me nenin 6 të KEDNJ-së.

61. Paneli thekson se procedurat para Dhomës së Posaçme filluan më 15 maj 2008, kur një grup i punëtorëve dorëzoi një ankesë kundër përfshirjes së ankueses në listën e përgatitur nga AKM-ja dhe përfunduan më 23 tetor 2008, me marrjen e vendimit të lartpërmendur. Ankuesja kufizon ankesën e saj në periudhën mes marrjes së vendimit më 23 tetor 2008 dhe njoftimin e saj për të, në një kohë në dhjetor të vitit 2008.

62. Paneli gjithashtu thekson se neni 45.4 i Udhëzimit Administrativ nr. 2006/17 të 6 dhjetorit të vitit 2006 siguron që "secilës palë t'i dorëzohet një kopje e vendimit brenda tridhjetë ditësh nga miratimi i tij". Prandaj, Paneli konsideron se periudhë maksimale për t'u marrë parasysh si periudhë e "vonesës" për njoftim për vendimin zgjati një muaj-nga 23 nëntori i vitit 2008, kur vendimi është dashur t'u dërgohet sipas afatit të fundit të përcaktuar prej një muaji, deri në dhjetor të vitit 2008, kur ankuesja u vu në dijeni për të.

63. Paneli thekson se PSSP-ja nuk ofron ndonjë koment që do të qartësonte arsyet për këtë vonesë. Megjithatë, duke marrë parasysh rrethanat e rastit, duke përfshirë faktin se ankuesja është duke jetuar si person i shpërngulur në Mal të Zi, ku ajo e kishte pranuar korrespondencën nga Dhoma e Posaçme, Paneli nuk e konsideron këtë vonesë të jetë e tepërt.

64. Prandaj, Paneli konstaton se, nuk ka pasur shkelje të të drejtave të ankueses për sa i përket njoftimit për vendim.

b) Shkelja e pretenduar e nenit 14 të KEDNJ-së, shpallur në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së

65. Ankuesja deklaron se Dhoma e Posaçme dështoi të marrë parasysh situatën e saj si pjesëtare e një minoriteti etnik, e cila ishte e detyruar të largohet nga Kosova në vitin 1999 duke pasur frikë për sigurinë e saj.

66. Paneli thekson se pohimi i ankueses se, duke e përjashtuar atë nga lista e punëtorëve të kualifikuar, Dhoma e Posaçme dështoi të marrë parasysh ekzistencën e një diskriminimi

indirekt ndaj saj si pjesëtare e minoritetit serb, ngrit një çështje sipas nenit 14 të KEDNJ-së, në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së. Ankuesja argumenton se ajo nuk u largua nga Kosova dhe nga vendi i saj i punës vullnetarisht, por për shkak të ekzistencës së kërcënimeve për sigurinë e saj si pjesëtare e minoritetit serb. Po t'u kishte lejuar situata e sigurisë personave të minoritetit serb dhe minoriteteve tjera etnike mundësi të qëndronin në Kosovë, ajo do të kishte mbetur në listën e pagave të ndërmarrjes, dhe kështu do të kishte pasur të drejtën e plotë për një pjesë të të ardhurave që rrjedhin nga privatizimi i saj. Paneli konsideron se ankuesja në thelb ankohet rreth dështimit të Dhomës së Posaçme që të korrigjojë një diskriminim ekzistues, nga i cili ankuesja dhe punëtorët e tjerë në situatën e njëjtë ishin viktima.

67. PSSP-ja, në komentet e tij për këtë pjesë të ankesës deklaron se Dhoma e Posaçme erdhi te përfundimi, në dritë të ligjit të aplikueshëm, se nuk kishte diskriminim ndaj ankueses. PSSP-ja argumenton se nuk është detyrë e Panelit të vlerësojë saktësinë e këtij vlerësimi, veç nëse ka "dëshmi se vendimet e tilla janë dhënë në një mënyrë padyshim të padrejtë dhe të pasaktë". Përveç kësaj, PSSP-ja pajtohet me vlerësimin e Dhomës së Posaçme se ankuesja nuk provoi pohimet se ajo ishte diskriminuar si pjesëtare e një minoriteti etnik.

68. Për sa i përket vërejtjes së PSSP-së lidhur me fushëveprimin dhe limitet e shqyrtimit të Panelit sipas nenit 14 të KEDNJ-së, në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, Paneli përsërit arsyetimin e paraqitur për sa i përket nenit 6 të marrë si të vetëm (shih § 53).

69. Duke iu referuar praktikës relevante gjyqësore të Gjykatës Evropiane lidhur me nenin 14, Paneli tanimë ka konstatuar se "një rregull përgjithësisht e aplikueshme, megjithëse mesa duket neutrale, mund të ketë efekt për trajtimin e njerëzve në mënyra të ndryshme, duke përfshirë trajtimin që bazohet në prejardhjen e tyre etnike. Kur një grup i personave është, për shkak të prejardhjes së vet etnike, në pozitë të cenueshme krahasuar me personat me prejardhje tjetër, autoritetet kompetente janë të obliguara të kenë konsideratë të veçantë për nevojat specifike të atij grupi të veçantë. Kjo konsideratë e veçantë kërkohet në të dyja në kornizën relevante rregullative dhe në vendimet në raste të veçanta" (shih, për sa i përket situatës së romëve në një numër të vendeve evropiane qendrore dhe lindore, GJEDNJ [DHL], *D.H. dhe të tjerët kundër Republikës Çeke*, përmendur në § 59 më lart, § 181; GJEDNJ [DHL], *Oršuš kundër Kroacisë*, përmendur në § 64 më lart, § 148; shih gjithashtu PKDNJ, *Parliq*, nr. 01/07, përmendur në § 53 më lart, § 57; dhe *Guga*, përmendur në § 49 më lart, § 79).

70. Paneli thekson situatën e cenueshmërisë në të cilën e gjetën veten minoritetet e shpërngulura menjëherë pas konfliktit të Kosovës. Në pajtim me qëndrimet e Panelit të paraqitura më herët, situata e tyre kërkonte aprovim të masave pozitive mbrojtëse nga autoritetet për t'u dhënë konsideratë të veçantë që të sigurohen të drejtat e tyre fundamentale, duke përfshirë ato në kuadër të procesit të privatizimit të ndërmarrjeve shoqërore në Kosovë (shih PKDNJ, *Parliq*, përmendur më lart, § 55; dhe PKDNJ, *Guga*, përmendur më lart,§ 80).

71. Paneli thekson se në nivel të kornizës ligjore, neni 10.4 i Rregullores së UNMIK-ut nr. 2003/13 i plotësuar me dispozitat e Ligjit Kundër Diskriminimit mbi peshën e dëshmisë, ofroi mbrojtje adekuate duke marrë parasysh se ai u ofroi të drejtën ish-punëtorëve që kanë qenë viktimë e diskriminimit direkt apo indirekt për një pjesë nga të ardhurat e privatizimit. Megjithatë, Paneli konsideron se Dhoma e Posaçme i zbatoi ato dispozita në rastin aktual, pa marrë parasysh situatën e veçantë të ankueses si pjesëtare e një minoriteti etnik, persekutimi i së cilës pas konfliktit ishte një çështje "përgjithësisht e njohur" që nuk kërkon dëshmi të mëtejme (në lidhje me këtë shih PKDNJ, *Guga*, përmendur më lart, §§

70-71). Kjo ishte pranuar nga AKM-ja (në§ 14 më lart) dhe ishte marrë në konsideratë nga Dhoma e Posaçme në rastet e tjera të privatizimit.

72. Paneli thekson me vlerësim se Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2003/13 dhe Ligji i Kosovës Kundër Diskriminimit ishin miratuar jo vetëm për të parandaluar diskriminimin por gjithashtu për të siguruar që procedurat gjyqësore do t'i bënin efektive garancitë ligjore për mosdiskriminim. Prandaj, në nenin 8.1 të Ligjit thuhet se kur personi që pohon për diskriminim provon fakte nga të cilat mund të supozohet diskriminimi, i takon palës që është paditur të rrëzojë pohimin për diskriminim.

73. Paneli thekson se, në përkrahje të pohimit të saj, ankuesja ia paraqiti faktet dhe gjithashtu dëshminë dokumentuese AKM-së dhe Dhomës së Posaçme se ajo kishte punuar në ndërmarrje për përafërsisht 24 vjet deri në mars të vitit 1999; se, kur armiqësitë shpërthyen në Kosovë në vitin 1999, duke pasur frikë nga persekutimi për shkak të etnisë së saj, ajo u largua si person i shpërngulur për në Mal të Zi dhe kështu nuk mund të punonte më në ndërmarrje. Paneli thekson se ankuesja gjithashtu i paraqiti një parashtresë Dhomës së Posaçme se ankesa e paraqitur kundër përfshirjes së saj në listë ishte e motivuar etnikisht.

74. Në dritë të kësaj që u tha më lart, Paneli konsideron se ankuesja kishte paraqitur fakte të mjaftueshme për të paraqitur një rast *prima facie* të diskriminimit para Dhomës së Posaçme i cili, sipas ligjit, paraqiti obligim për të paditurit, punëtorët që kundërshtonin përfshirjen e ankueses në listë, të dëshmojnë se ankuesja, në fakt, nuk kishte qenë viktimë e një trajtimi diskriminues. Sipas mendimit të Panelit, për të treguar një dëshmi më të detajuar për diskriminim, bazuar në rrethanat konkrete, do të vendoste një peshë të pajustifikueshme mbi një numër të madh të komuniteteve minoritare.

75. Megjithatë, Dhoma e Posaçme dështoi ta zbatojë nenin 8.1 të Ligjit Kundër Diskriminimit; ajo pohoi se ankuesja "nuk dëshmoi se ajo ishte diskriminuar" dhe kështu nuk kërkoi nga punëtorët që kundërshtonin përfshirjen e saj në listë t'i kundërshtonin pohimet e saj për diskriminim. Dhe Dhoma e Posaçme as që dha ndonjë arsye për këtë.

76. Prandaj, Paneli konsideron se Dhoma e Posaçme ka vepruar në mënyrë diskriminuese përmes dështimit të saj për të marrë parasysh diskriminimin e pësuar nga ankuesja dhe dështimit të saj që ta ndryshojë peshën e dëshmisë siç kërkohet me nenin 8 të Ligjit Kundër Diskriminimit.

77. Duke pasur parasysh krejt këtë që u tha më lart, Paneli thekson se ankuesja i ka paraqitur atij fakte të mjaftueshme për të provuar se Dhoma e Posaçme nuk e trajtoi atë sipas parimit të mosdiskriminimit. Paneli konsideron se kjo paraqet një rast *prima facie* të diskriminimit të cilin PSSP-ja nuk e ka hedhur poshtë.

78. Prandaj, Paneli përfundon se ka pasur shkelje të nenit 14, në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së.

V. KOMENTE DHE REKOMANDIME PËRFUNDIMTARE

79. Paneli rikujton se ai ka konstatuar se e drejta e ankueses për një gjykim të drejtë është shkelur. Përveç kësaj, Paneli ka konstatuar se ankuesja ishte viktimë e diskriminimit të bazuar në etninë e saj në procedurat para Dhomës së Posaçme.

80. Paneli gjithashtu rikujton se diskriminimi racor dhe diskriminimi i bazuar në prejardhje etnike përbëjnë një lloj veçanërisht të padrejtë të diskriminimit i cili, duke pasur parasysh pasojat e veta, kërkon nga autoritetet një "reagim energjik" kurdo që është identifikuar një rast i diskriminimit direkt apo indirekt (shih § 69 më lart).

81. Paneli thekson se në rastin aktual, do të ishte normale që UNMIK-u t'i marrë masat e duhura me qëllim që t'i ndalë shkeljet e gjetura dhe t'i korrigjojë aq sa është e mundshme efektet nga kjo. Megjithatë, Paneli tanimë ka theksuar në rastet tjera të sjella para tij (shih, në mes tjerash, PKDNJ, *S.C.*, nr. 02/09, mendimi i 6 dhjetorit të vitit 2012; dhe *Laliq*, nr. 31/08, mendimi i 14 marsit të vitit 2013) se, pas shpalljes së pavarësisë nga Institucionet e Përkohshme të Vetëqeverisjes të Kosovës, më 17 shkurt 2008, dhe më pas hyrjes në fuqi të Kushtetutës së Kosovës më 15 qershor 2008, UNMIK-u ndaloi kryerjen e funksioneve ekzekutive në Kosovë, dhe këto fakte kufizuan aftësinë e tij për të siguruar korrigjim të plotë dhe efektiv të shkeljeve të kryera. Paneli gjithashtu ka theksuar se përgjegjësia e UNMIK-ut në lidhje me drejtësinë në Kosovë përfundoi më 9 dhjetor 2008, me marrjen përsipër nga Misioni për Sundim të Ligjit i Bashkimit Evropian (EULEX-i) të kontrollit operacional në fushën e zbatimit të ligjit.

82. Paneli konsideron se kjo situatë faktike nuk e liron UNMIK-un nga obligimi i tij për t'i korrigjuar aq sa është e mundshme efektet e shkeljeve për të cilat është përgjegjës.

Për sa i përket ankueses dhe rastit Paneli konsideron se është e nevojshme që UNMIK-u:

- Në pajtim me praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut në situatat me juridiksion të kufizuar të shtetit, Paneli është i mendimit se UNMIK-u duhet bërë përpjekje, me të gjitha mjetet diplomatike në dispozicion të tij *vis-à-vis* EULEX-it dhe autoriteteve tjera kompetente në Kosovë (shih GJEDNJ [DHL], *Ilaşcu dhe të tjerët kundër Moldavisë dhe Rusisë*, nr. 48787/99, vendimi i gjykatës, 8 korrik 2004, § 333; KEDNJ 2004-VII; GJEDNJ, *Al-Saadoon dhe Mufdhi kundër Mbretërisë së Bashkuar*, nr. 61498/08, vendimi i gjykatës, 2 mars 2010, § 171, KEDNJ 2010 (ekstraktet); GJEDNJ (DHL), *Catan dhe të tjerët kundër Moldavisë dhe Rusisë*, nr. 43370/04 dhe të tjerët, vendimi i gjykatës, 19 tetor 2012, në § 109; shih gjithashtu PKDNJ, *Millogoriq dhe të tjerët*, nr. 38/08 dhe të tjerët, mendimi i 24 marsit të vitit 2010, në § 49) të sigurojë se do të ndërmerren hapa drejt mundësimit të rihapjes së rastit të ankueses nga Dhoma e Posaçme dhe shqyrtimit të tij në pajtim me standardet e KEDNJ-së, nëse ankuesja e dëshiron këtë (shih GJEDNJ [DHL], *Sejdoviq kundër Italisë*, nr.56581/00, vendimi i 1 marsit të vitit 2006, në §§125-127; dhe GJEDNJ, *Paraskeva Todorova kundër Bullgarisë*, nr. 37193/07, vendimi i 25 marsit të vitit 2010, në §52).

- Të pranojë publikisht, brenda një kohe të arsyeshme, përgjegjësinë për sa i përket dështimit të Dhomës së Posaçme të gjykojë ankesën e ankueses në një bazë jodiskriminuese, dhe t'i kërkojë falje publike ankueses për këtë;

- Të ndërmarrë hapa të duhur për pagesën e kompensimit adekuat për ankuesen, për dëmin e shkaktuar jomaterial si rezultat i diskriminimit të saj në procedurat para Dhomës së Posaçme.

Paneli gjithashtu e konsideron të nevojshme që UNMIK-u:

- Të ndërmarrë hapa të duhur për sa i përket autoriteteve kompetente në Kosovë për të siguruar zbatim të plotë të Ligjit Kundër Diskriminimit si një garanci për mospërsëritje.

PËR KËTO ARSYE,

Paneli, unanimisht,

1. **KONSTATON SE KA PASUR SHKELJE TË 6 TË KEDNJ-së;**

2. **KONSTATON SE KA PASUR SHKELJE TË NENIT 14 TË KEDNJ-së, NË LIDHJE ME NENIN 6 TË KEDNJ-së;**

3. **REKOMANDON QË UNMIK-u:**

   a. **T'U KËRKOJË EULEX-it DHE AUTORITETEVE TË TJERA KOMPETENTE NË KOSOVË QË TË NDËRMARRIN HAPA PËR TË MUNDËSUAR RIHAPJEN E RASTIT TË ANKUESES NGA DHOMA E POSAÇME DHE SHQYRTIMIN E TIJ NË PAJTIM ME STANDARDET E KEDNJ-së, NËSE ANKUESJA E DËSHIRON KËTË;**

   b. **T'I KËRKOJË FALJE PUBLIKE ANKUESES PËR DËSHTIMIN E DHOMËS SË POSAÇME QË TË GJYKOJË ANKESËN E SAJ NË NJË BAZË JODISKRIMINUESE;**

   c. **TË NDËRMARRË HAPA TË DUHUR DREJT PAGESËS SË KOMPENSIMIT ADEKUAT ANKUESES PËR DËMIN JOMATERIAL TË SHKAKTUAR SI REZULTAT I DISKRIMINIMIT;**

   d. **TË LIDHET ME AUTORITETET KOMPETENTE NË KOSOVË PËR TË SIGURUAR ZBATIM TË PLOTË TË LIGJIT TË KOSOVËS KUNDËR DISKRIMINIMIT SI NJË GARANCI PËR MOSPËRSËRITJE;**

   e. **TË MARRË MASA TË MENJËHERSHME DHE EFEKTIVE PËR T'I ZBATUAR REKOMANDIMET E PANELIT DHE TË INFORMOJË ANKUESEN DHE PANELIN RRETH ZHVILLIMEVE TË MËTEJME PËR KËTË RAST.**

Andrey Antonov
Zyrtar ekzekutiv

Marek Nowicki
Kryesues